

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**SPV "BILISHT SOLAR PARK 1" Sh.p.k.
SUBJEKT PER QËLLIME TE VECANTA**

KAPITULLI I FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria SPV "BILISHT SOLAR PARK 1" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Statuti eshte në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në te, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është **SPV "BILISHT SOLAR PARK 1" Sh.p.k.**
- 2.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2. Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë:
 - Shoqeria do te kete per objekt kryesor aktiviteti ndertimin, mirembajtjen dhe operimin e centralit gjenerues te energjise elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmese, tregtimin e energjise elektrike qe do te prodhohet nga centrali gjenerues, si dhe çdo veprimtari tjeter ne funksion te realizimit te projektit.
 - Per arritjen e qellimit te mesiperm.
 - Shoqeria mund te kryej cdo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, ligjor, qe lidhet direkt ose indirekt, me objektin e mesiperm dhe qe mund te konsiderohet i nevojshem ne menyre qe te ushqrohet aktiviteti i Shoqerise.
- 3.3. Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, me individë, shoqëri tregtare,
ente publike apo private, në lidhje me aktivitetin e saj bazë, siç citohet në pikën 3.2 të Statutit. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter të nevojshëm

apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në adresën **Bilisht zk 3804 NR PASURIE 1723**.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjeter bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të percaktoje afatin e perfundimit te ekzistences se saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, ORTAKET, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar dhe ortaket

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke (njeqind mijë leke)
 - Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuota, me vlerë te pergjithshme 100.000 leke (njeqind mijë leke)
 - të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera.
- 6.2 Ortaket themelues te shoqerise jane:
 - Shoqeria “ARNA” shpk, , me NIPT (nus) K14128001J, dhe seli ne adresen: Korce Drenove Boboshtice Rruga Nacionale Korce - Boboshtice, Km 4, Zona Kadastrale 1538, Nr Pasurie 578/1, Tek Zapet
 - Shoqeria “Vildev - Co” shpk, me NIPT (nus) K83926001F, dhe seli ne adresen: Korce, Lagjja 17, Rruga Riza Mance, Nr 21.
 - Shoqeria “DRITE” shpk, , me nipt(nus) M31320017F, dhe seli ne adresen Rr. “3 Deshmoret”, Pallati Grand Investment, Tirane.

6.3 Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin themeltar.

- 6.4 Bazuar në Ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, indryshuar ne VKM Nr. 822, datë 7.10.2015 “për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, shoqeria ploteson kriteret e venojshme te percaktuara ne bazen ligjore te sipercituar, per marrjen e miratimeve paraprake nga Organet Publike, per kete arsy:

Neni 7 - Kontributet

7.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Shoqeria ARNA shpk, ka ofruar 60.000 (gjashtedhjete mijë) leke
- Shoqeria Vildev - Co shpk ka ofruar 20.000(njezet mijë) leke
- Shoqeria DRITE shpk, ka ofruar 20.000 (njezet mijë) leke

7.2. Sipas kontributeve të mësipërme:

- Shoqerise Arna shpk, i përkasin 1 (nje) kuota, që i korrespondojnë 60% (gjashtedhjete përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Shoqerise Vildev - Co shpk, i përkasin 1 (nje) kuota, që i korrespondojnë 20% (njezet përqind) të kapitalit të Shoqërisë
- Shoqerise Drite shpk, i përkasin 1 (nje) kuota, që i korrespondojnë 20% (njezet përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8- Anulimi i kuotave

- 8.1 Në rast se ndonjëri nga ortakët nuk ka mundësi parafinancimi të projektit sipas kuotave takuese, shuma do te paguhet nga ortaket e tjerë.
- 8.2 Asambleja e Përgjithshme vendos anullimin e kuotës së ortakut që nuk ka mundësi parafinancimi të projektit sipas parashikimeve të pikës 8.1. Në rastin e anulimit të kuotës, ortaku likuidohen në vlerën e kontributit të derdhur në kapitalin themeltar.
- 8.3 Në rast se pamundësia e parafinancimit është e pjesshme, atëherë anullimi i kuotës është gjithashtu i pjesshëm, në proporcion të drejtë me pjesën e munguar të parafinancimit.
- 8.4 Në rast të anulimit të kuotës së njërit ortak sipas parashikimeve në pikën 1 dhe 2 të këtij nenii Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërndarjen e kuotave te ortakët e tjerë në përputhje me kontibutin financier të secilit ortak.
- 8.5 Të drejtat e detyrimet, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anulimin e saj.

Neni 9– Rritja e kapitalit themeltar

- 9.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 9.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 11 – Transferimi i kuotave

11.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

11.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve te SPV.

11.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij, duhet të njoftoje ortakët e tjerë te SPV, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje.

11.4 Kuotat nuk mund te transferohen/dhurohen/shiten pjesërisht paleve te treta.

11.5 Ortakët e SPV do të kenë në dispozicion 10 (dhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

11.6 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përvèç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

11.7 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve vetem plotësisht, me vendimin pozitiv 51% te Asamblesë së Ortakëve. Te tretet jane subjekte te cilat mund te shprehin interesin per blerjen e kuotave

11.8 Në rast të mylljes, falimentimit, pezullimit, bashkimit, përzierjes etj. apo të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie, ndryshimit të ortakëve/administratorëve të shoqërive ortake të Shoqërisë SPV "BILISHT SOLAR PARK 1" Sh.p.k ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët/administratorët/përfaqësuesit e rinj . Në rast se ortakët nuk jepin pëlqimin, do të procedohet me anulimin e kuotës sipas parashikimeve në nenin 8.2, 8.3, 8.4 të Statutit.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 12 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat e saj

12.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

12.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e satutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimë dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjeter parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 13 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

13.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.

13.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

13.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim pér një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht pér pjesën e mbetur.

Neni 14 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, kuorumi dhe vendimet

14.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar pér miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.

14.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit të ortakëve të paktën 7 ditë përpara datës së parashikuar pér mbledhjen e Asamblesë. Thirrja duhet të përbajë informacion mbi rendin e ditës në lidhje me çështjet që do të trajtohen dhe pér të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e mbledhjes.

14.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

14.4 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm te ortakëve që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, të cilët janë dakord të marrin vendime panvarësisht parregullsisë së njoftimit.

14.5 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, pér të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (trihjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, pér të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

14.6 Asambleja e Ortakëve vendos pér:

- ndryshimet e satutit,
- zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit të regjistruar
- shperndarjen e fitimeve
- riorganizimin dhe pridhjen e Shoqerise

me votat e 3/4 (tretekatertat) te ortakeve pjesemarres, te cilet jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me mjete elektronike, te cilet perfaqesojnë te pakten 51% (pesdhjetenje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Voten pro te shumices se ortakeve te pranishem, qe perfaqesojne mbi 30% (tridhjete per qind) te kapitalit themeltar per:

- Percaktimi i politikave tregetare
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar

- Percaktimi i shperblimeve per administratoret, likujduesit dhe ekspertet.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- Pjestimi i kuotave dhe anullimi i tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedime te tjera ndaj administratoreve
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

14.7 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjeter i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emeron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

14.8 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari dhe regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve.

Neni 15 – Administrimi

15.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët do të veprojnë si veçmas ashtu edhe bashkërisht. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh dhe janë të rizgjedhshëm. Në rast se Asambleja nuk merr vendim përparrë mbarimit të afatit në detyrë të Administratorëve, mandati i këtyre të fundit do të rinovalohet automatikisht sipas afatit të përcaktuar në këtë Statut.

15.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë u besohet Administratorëve. Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha fuqitë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

15.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

15.4 Administratori i parë i Shoqërisë eshte :

- Z. Jani Kapurani, i datëlindjes 03/05/1985, lindur në Boboshtice dhe banues në Korce , mbajtës i leter njofteimit nr 038148928, dhe nr personal I50508039R

14.5 Administratori do të qëndrojë në detyrë per një periudhe 5 (pese) vjecare, me të drejtë riemerimi.

14.6 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve me nënshkrimin e administratorit/administratoreve.

14.7 Administratori i Shoqërisë administron veprimtarinë e shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme, përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie më çdo palë të tretë, merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave, përgatit dhe nënshkruan pasqyrat vjetore financiare dhe bilancet e konsoliduara, përgatit raportin e ecurisë dhe i dorëzon këto të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve në Asamblenë e Përgjithshme për miratim, krijon sistemin e paralajmërimtit në lidhje me rr Ethanat të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë, dorëzon në QKR dokumentat dhe të dhënët e Shoqërisë përvèç rasteve kur ligj

parashikon ndryshe, raporton në Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për securinë e Shoqërisë, kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky statut, është i autorizuar për të siguruar mjetet financiare dhe kredi, të lidhë marrëveshje përkatëse me banka, institucion krediti ose financiare vëndase ose të huaja, duke përdorur si mjete garancie në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi asetet e Shoqërisë.

Neni 16– Eksperti kontabël i autorizuar

- 16.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 16.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17 - Viti finansiar dhe bilanci vjetor

- 17.1 Viti finansiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 17.2 Viti i parë finansiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtë vit.
- 17.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga ligji 9901 me datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 17.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin finansiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vittit finansiar.

Neni 18 – Fitimet

- 18.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcione pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 18.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve -plotësisht ose pjesërisht - për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË **Neni 19 – Prishja**

- 19.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përparrë përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 19.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose


- 20.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 20.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 20.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Ortakëve do të vendosë mbi bilancin finansiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 20.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 21 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 21.1 Të gjitha mosmarrëveshet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 21.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce.

ORTAKET E SHOQERISE


ARNA SHPK




VILDEV - CO SHPK




DRITE SHPK




DRITË SH.P.K
NUIS: M31320017F
Tiranë, Albania

Korce me 01/04/2024